



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 137, datë 30.07.2018

PËR

**MIRATIMIN E AGJENTËVE NË SIGURIME NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGMA INTERALBANIAN VIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 199, pika 2, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, me propozim të Zyrës së Licencimit, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Zj. Hajrie Disha, Zj. Vjollca Nesimi, Zj. Florida Grosler, Z. Xhon Lena, Z. Xhelal Tafaj dhe Z. Lisandër Leka për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Sigma Interalbanian VIG” sh.a.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI